



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 592/ 9 prot.,

Datë 26.03.2026

V E N D I M
Nr. 431 /2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Gjergj Mersini	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.03.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt:

Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 358/2026, datë 06.03.2026 për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar“, me nr. REF-76569-02-18-2026, me objekt: “Blerje materiale elektrike”, me fond limit 8,245,000.00 Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 02-03-2026, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Publike Berat, dhe vendimit nr. 363/2026 datë 09.03.2026 për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-75346-02-05-2026, me objekt: “Blerje materiale elektrike, me fond limit 8,307,000.00 Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 17-02-2026, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Publike Berat.

Ankimues:

Operatori ekonomik “KetaElite” sh.p.k, NIPT M46915401B, me adresë: Shetitorja Qyteti i Ri, nd.23; H. 6; zona kadastrale 8611; Bulqize .

Operatori ekonomik “Optima Communications” SH.P.K,
Rruga Shyqyri Berxolli, Pallati Inter Co-Sat, Seksioni B,
Kati i 6-të, Nr. 6/5, Dera 28B, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Agjencia e Shërbimeve Publike Berat, me adresë: Rruga
Baki Gjebrea, Berat

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar,
Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021
“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i
ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik
nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave
“Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të
Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

I.1. Në datë 06.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 358/2026, ku vendosi:
[...]

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “KetaElite sh.p.k për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-76569-02-18-2026, me objekt: “Blerje materiale elektrike”, me fond limit 8,245,000.00 Lekë Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 02-03-2026, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Publike Berat.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, sipas vendimit të KSHA dhe KPP si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse, për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “KetaElite” sh.p.k.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2 Në datë 09.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 363/2026, ku vendosi:
[...]

1.Të mbyllë çështjen, për pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Optima Communication” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr. REF-75346-02-05-2026, me objekt: “Blerje materiale elektrike, me fond limit 8,307,000.00 Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 17-02-2026, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Publike Berat.

2.Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Optima Communication” sh.p.k për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-75346-02-05-2026, me objekt: “Blerje materiale elektrike, me fond limit 8,307,000.00 Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 17-02-2026, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Publike Berat.

3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, sipas vendimit të KSHA dhe KPP si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.

4.Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kalimin e tarifës financiare në buxhet të shtetit, të paguar nga operatori ekonomik “Optima Communications ” sh.p.k.

6.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

7.Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

1.3. Me shkresën nr. 196/10 prot., datë 11.03.2026, protokolluar me tonën nr. 592/6 prot., datë 13.03.2026 autoriteti kontraktor, ka dërguar informacion për procedurën “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-76569-02-18-2026, me objekt: “Blerje materiale elektrike”, me fond limit 8,245,000.00 Lekë Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 02-03-2026, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Publike Berat, ku në përmbatje të saj njofton se ka zbatuar vendimin nr. 358/2026 si dhe ka bashkëlidhur shkresat - Dokumentat standarte të tenderit të modifikuara.

1.4 Me shkresën nr. 207 prot., datë 13.03.2026, protokolluar me tonën nr. 463/7 prot., datë 19.03.2026 autoriteti kontraktor, ka dërguar informacion për procedurën “E hapur, e thjeshtuar”, REF-75346-02-05-2026, me objekt: “Blerje materiale elektrike, me fond limit 8,307,000.00 Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 17-02-2026, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Publike Berat, ku informon se ka zbatuar vendimin nr. 363/2026 duke informuar se: “Bëjmë me dije KPP se modifikime e realizuara në kuadër të prokurimit me nr. REF-76569-02-18-2026 kanë pasqyruar në modifikimet e kriterëve të tenderimit dhe vendimarrjen e KSHA dhe KPP për tenderimin me nr. REF-75346-02-05-2026.”.

II Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1 Me shkresën nr. 196/10 prot., datë 11.03.2026, protokolluar me tonën nr. 592/6 prot., datë 13.03.2026 autoriteti kontraktor, ka dërguar informacion për procedurën “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-76569-02-18-2026, me objekt: “Blerje materiale elektrike”, me fond limit 8,245,000.00 Lekë Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 02-03-2026, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Publike Berat, ku në përmbatje të saj njofton se ka zbatuar vendimin nr. 358/2026 si dhe ka bashkëlidhur shkresat - Dokumentat standarte të tenderit të modifikuara.

II.2 Me shkresën nr. 207 prot., datë 13.03.2026, protokolluar me tonën nr. 463/7 prot., datë 19.03.2026 autoriteti kontraktor, ka dërguar informacion për procedurën “E hapur, e thjeshtuar”, REF-75346-02-05-2026, me objekt: “Blerje materiale elektrike, me fond limit 8,307,000.00 Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 17-02-2026, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Publike Berat, ku informon se ka zbatuar vendimin nr. 363/2026 ku bënë me dije se KPP se modifikimet e realizuara në kuadër të prokurimit me nr. REF-76569-02-18-2026 i ka pasqyruar në modifikimet e kritereve të tenderimit dhe vendimarrjen e KSHA dhe KPP, për tenderimin me nr. REF-75346-02-05-2026.”.

Gjithashtu duke vijuar më tej autoriteti kontraktor ka informuar se për objektin e prokurimit me REF-75346-02-05-2026, AK ka proceduar me anullim me datë 12.02.2026, datë në të cilën rezulton e ardhur në sistemin elektronik dhe ankesa e operatorit ekonomik ankimues për këtë procedurë, duke qënë se ka konstatuar mangësi lidhur me fondin limit, gjithashtu informon se sa i përket ankesës së operatorit ekonomik ankimues për këtë procedure prokurimi, autoriteti kontraktor bënë me dije se, pasi ka trajtuar ankesën dhe pasi ka informuar KPP, ka pasqyruar dhe modifikimet për këtë numër reference në procedurën e re të rishpallur, përkatësisht me nr. REF-76569-02-18-2026.

Përsa më sipër Komisioni vlerëson se referuar informacionit të përcjellë nga autoriteti kontraktor si dhe gjithashtu verifikimeve të shtojcës së modifikuar publikuar në sistemin elektronik AK ka zbatuar vendimet nr.358/2026 dhe vendimin 363/2026 të Komisionit të prokurimit publik.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020

“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

VENDOS:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-76569-02-18-2026, me objekt: “Blerje materiale elektrike”, me fond limit 8,245,000.00 Lekë Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 02-03-2026, nga autoriteti kontraktort, Agjencia e Shërbimeve Publike Berat.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

